

1 VEND I LIRË PËR PUNONJËS ADMINISTRATIV(PUNONJËS MIRËMBAJTJE-MARANGOZ) NË GARDËN E REPUBLIKËS

I. KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJNË KANDIDATËT :

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të mos jetë përjashtuar ose larguar nga puna për shkelje ligjore apo disiplinore;
- c) të jetë i aftë nga ana shëndetësore;
- ç) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundra vajtjeje penale me dashje;
- d) të mos jetë në ndjekje penale;
- dh) të mos i jetë hequr e drejta e ushtrimit të funksioneve në administratën publike me vendim gjyqësor të formës së prerë.
- e) të ketë njohuri si marangoz

Aplikanti që nuk plotëson qoftë edhe 1 nga kriteret e mësipërme, nuk kualifikohet dhe nuk duhet të vazhdojë aplikimin.

II. DOKUMENTAT QË DUHET TË PARAQESIN KANDIDATËT:

Aplikantët duhet të paraqesin në Sektorin e Burimeve Njerëzore dokumentet e mëposhtëme:

- a) kërkesë me shkrim;
- b) fotokopje të kartës së identitetit;
- c) certifikatë të gjendjes shëndetësore;
- ç) vërtetim gjykate;
- d) vërtetim prokurorie;
- dh) referenca për punët e kryera gjatë periudhës që ka qenë në lirim.
- e) dy foto (9 X 12) me këmishë dhe kollare.
- ë) fotokopje të librezës së punës

Dokumentat do të dorëzohen dorazi nga aplikanti në adresën: Garda e Republikës, Rruga e Elbasanit, Pallati i Brigadave, Tiranë, brenda datës 12.08.2024.

III. SHQYRTIMI I DOKUMENTACIONIT DHE PROCESI I ANKIMIMIT

- Afati i shqyrtimit dhe verifikimit të dokumentacionit është 3 ditë pune nga mbyllja e afatit të aplikimeve.
- Aplikanti, që nuk plotëson kriteret dhe nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar brenda afatit të aplikimit, skualifikohet.
- Aplikanti ka të drejtën e ankimit brenda 2 ditëve nga data e njoftimit të përgjigjes. Komisioni i apelimit shqyrton dhe kthen përgjigje brenda 2 ditëve nga data e marrjes së ankesës me telefon ose adresë e-mail.

IV. TESTIMI I KANDIDATËVE

Intervista dhe testi psikologjik, me kandidatët e kualifikuar në fazën e shqyrtimit të dokumenteve do të zhvillohet **prej orës 08⁰⁰ deri në orën 12⁰⁰ të datës 16.08.2024**, në adresën: Garda e Republikës, Rruga e Elbasanit, Pallati i Brigadave, Tiranë,

V. NJOFTIMI I FITUESVE

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, të gjithë kandidatët fitues në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike (e-mail personal) ose me telefon nga Garda e Republikës